

**Tomor Aliko**

## **PASQYRIMI I BURGJEVE DHE KAMPEVE TË INTERNIMIT GJATË REGJIMIT KOMUNIST**

*(Marrë nga “Genocidi mbi elitën intelektuale të Kombit Shqiptar”)*

Në këtë kumtesë bëhet fjalë për periudhën e fillimit të diktaturës të regjimit komunist në Shqipëri, nga fundi i vitit 1944 e deri në vitin 1952, ku me vendim të gjykatave speciale u eliminua pothuajse i gjithë truri i kombit shqiptar. Nëpër qelitë e tmerrshme të burgjeve komuniste qindra vuajtës kanë vdekur nga torturat çnjerëzore. Ndaj tyre janë thurrur kurthe, intriga, dëshmi të rreme e akuza false. Nëpër qelitë e tmerrshme të burgjeve komuniste u shua përfundimisht ose u tjetërsua në mënyrë të dhimbshme jeta e qindra njerëzve të pafajshëm. Qenë pikërisht këta njerëz, që e paguan me jetë aspiratën e tyre për liri e demokraci. Ata qenë viktimat e para të atij sistemi stalinist, që po vendosej në Shqipëri. Por fati i tyre tragjik nuk përfundoi me kaq. Mbi familjarët dhe të afërmit e tyre do të ushtrohej një kalvar i mundimshëm vuajtjesh nëpër kampet e internimit, të cilat u shtuan dhe u shumuan vit pas viti, sepse lufta e klasave, duke i kaluar të gjitha caqet njerëzore sa vinte e bëhej më e egër. Pikërisht sot, pasi kanë kaluar shumë vite me gjakftohtësi e mendje të

kthjellët me të drejtë na lind pyetja: -Vallë a qenë të drejta ato vendime dhe gjykime për qindra njerëz të pafajshëm? Ndonëse nuk kishin bërë asnjë krim, papritur drita e fatit të tyre u nxi dhe mbi ta nisi rrebeshi i egër stalinist, duke ju shkatërruar çdo gjë, që e patën ndërtuar me mund e me djersë. Përse duhej të derdhej gjithë ai gjak i pastër shqiptari?<sup>1</sup>

Që vitet e para të vendosjes së diktaturës staliniste në Shqipëri fillojnë ekzekutimet masive pa gjyq ndaj nacionalistëve, patriotëve, intelektualëve dhe ish-funksionarëve të shtetit. Diktatura veproi egërsisht mbi këta njerëz patriotë pasi tek ata shikonte pengesën kryesore në marrjen dhe mbajtjen e pushtetit. Eliminimi fizik i tyre ka qenë fatkeqësia më e madhe për kombin shqiptar.

**Gjyqi i parë special i Tiranës, në vitin 1945.** Më 31 dhjetor të vitit 1944 në burgun e vjetër të Tiranës vuanin dënimin rreth 600 burra, të cilët iu nënshtruan një hetuesie të reptë. Ata i nxorrën para gjyqit special, në kundërshtim me të gjitha konventat ndërkombëtare të iniciuara nga fituesit e Luftës së Dytë Botërore. Ky gjyq u zhvillua në mars-prill 1945 në sallën e Teatrit Popullor. Gjyqi ishte një farsë e menduar që më parë nga pushtetarët komunistë, por në të vërtetë ishte drama e dhimbshme e fateve njerëzore të elitës intelektuale të kombit shqiptar. Po zhvillohej një nga gjyqet më absurd dhe më të pamotivuar nga ana juridike, jehona e të cilit do të oshëtinte gjatë në veshët e shqiptarëve si një kabanë ogurzezë, që paralajmëronte tragjeditë e ardhshme. Nën gjëmimin e altoparlantëve, që jepnin këngë partizane, grupi i gjyqtarëve dha dënimin ***në emër të popullit***, duke çuar para grykave të zjarrit 17 burra shteti, që nuk kishin kryer asnjë

---

<sup>1</sup> Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të Kombit Shqiptar*, Maluka, Tiranë, 2007, faqe 10-11.

krim, përveçse kishin qenë shtetarë të denjë të vendit të tyre. Në llozhën e sallës së gjyqit qëndronte Enver Hoxha, udhëzuesi i këtij skenari makabër.

**Trupi gjykues i përbërë nga:** Koci Xoxe kryetar, gjeneral lejtant, Hysni Kapo anëtar, kolonel, Beqir Balluku anëtar, nënkolonel, Faik Shehu anëtar, nënkolonel, Bilbil Klosi anëtar, major, Medar Shtylla anëtar, mjek, Halim Budo anëtar, jurist, Gaqo Floqi anëtar, jurist dhe prokuror Bedri Spahiu dha vendimin:

**Dënohen me pushkatim:** Fejzi Alizoti, Javer Hurshiti, Kol Tromara, Kostandin Kote, Hilmi Leka, Reshit Merlika, Ismail Golemi, Tahsim Bishqemi, Terenc Toçi, Zef Kadarja, Shyqyri Borshi, Beqir Valteri, Bahri Omari, Dik Cani, Aqif Permeti, Daut Çarçani, Gustav Mirdashi. Të tjerët u dënuan me burgim të rëndë. Koço Kota, Kryeministër i Shqipërisë në vitet 1935-1939; Ibrahim Biçaku, Kryeministër në vitet 1943-1944; Xhevat Korça, ministër; Qemal Vrioni, ministër; Et'hem Cara, ministër; Xhevat Leskoviku, ministër; Jakov Mile, ministër; Ndoc Naraci, ministër; Tefik Mborja, ministër; Musa Gjylbegu, ministër; Koco Tasi, nënpunës i lartë etj. Pas gjyqit special të vitit 1945, u arrestua dhe u burgosën tri personalitete politike, dy prej të cileve qenë anëtarë të Regjencës në vitet 1943-1944: Lef Nosi dhe Patër Anton Harapi si dhe kryeministri i asaj periudhe, Maliq Bushati. Në janar të vitit 1946 ata i dënuan me vdekje me pushkatim.<sup>2</sup>

Cila është vallë ajo forcë hyjnore që mund të mundojë përsëri njerëz të pafajshëm të lidhur me pranga, duke i kalbur në gropa të përbashkëta dheu pa asnjë lloj adrese. Në vitet 1945-1948, nacionalizmi shqiptar pësoi persekutimin më

---

<sup>2</sup> Melsi Labi, Dorian Koçi, *Udhërrëfyes i Muzeut Historik Kombëtar*, Tiranë 2014, faqe 75.

barbar që ka njohur historia. Diktatura gjakatare komuniste dënoi intelektualë, patriotë dhe njerëz të shtresave të pasura. Diktatori Enver Hoxha ngarkoi ministrin e brendshëm të atyre viteve, gjeneralin Koci Xoxe, për kryerjen e këtij misioni, i cili me anë të sigurimit të shtetit, policisë, prokurorisë dhe gjykatave ushtarake vuri në zbatim direktivat e Byrosë Politike për asgjësimin e trurit të elitës intelektuale të kombit shqiptar. Në këto rrethana, elementët kundërshtarë nisën të grumbulloheshin dhe të reflektonin rreth këtij uzurpimi të dhunshëm të vetedijës kolektive shqiptare. Qenë zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1945. Këto zgjedhje edhe pse u monitoruan nga perëndimorët dhe kryesisht nga anglo-amerikanët, liria e tyre u mbyt nën tam-tamet delirante të partisë-shtet, nën terrorin policor dhe dënimet e të gjithë elementëve të dyshuar si opozitarë të regjimit komunist. U piketuan intelektualë nga Fronti i Rezistencës, Legaliteti dhe nga grupimi Social-demokrat. Këta qenë njerëz të ndershëm që e donin vendin e tyre, por që nuk pajtoheshin me stilin agjenturor jugosllav, që dominonte udhëheqjen shqiptare të asaj kohe. Sami Qeribashi, Qenan Dibra e Musine Kokalari qenë figurat e para intelektuale dhe politike që iu kundërvunë diktaturës. Me ta u bashkuan edhe intelektualë të tjerë si Suat Asllani dhe Baltazar Benusi. Ndër më të spikaturit opozitarë ka qenë Gjergj Kokoshi, ish Ministër i Arsimit. Në janar të vitit 1946 sigurimi i shtetit dhe struktura të tjera të diktaturës ndërmorrën një valë të gjerë arrestimesh në mbare vendin. U arrestuan anëtarët e Bashkimit Demokrat në Tiranë e rrethe, të cilët iu nënshtruann torturave më çnjerëzore në hetuesi, thjesht për faktin sepse kishin guxuar, sipas kushtetutës shqiptare të dilnin në opozitë me pushtetin në themel të së cilit ishte dhuna dhe demagogjia.

**Gjykata e Lartë Ushtarake** me kryetar Frederik Nosi, major, Veledin Hyseni dhe Nexhat Hyseni anëtar, kapiten të parë dha vendimin:

**Dënohen me pushkatim 9 veta:** Sami Qeribashi, Qenan

Dibra, Xhahit Koka, Mehmet Beshiri, Mahmut Meniku, Hivzi Gole, Shaban Balla, Ali Kavaja dhe Talat Drini.

**Dënohen me burgim të rëndë:** Musine Kokalari, Gjergj Kokoshi, Suat Asllani, Baltazar Benusi, Prof Çoka, Kol Rodhe, Nefail Shikuli, Reiz Hasho, Hasan Kalaja, Stefan Bumçi, Musa Dizdari, Llazar Papapostoli, Anton Dukagjini etj.<sup>3</sup>

Më 8 Nëntor 1946, në sallën e Kinemasë Nacionale filloi gjykimi kundër 16 anëtarëve të grupit sabotator për tharjen e kënetës së Maliqit. Me këtë gjyq filloi një akt tjetër mizor i dramës njerëzore më ndëshkimit të ashtuquajturve “sabotatorë” të tharjes së kënetës së Maliqit. Anëtarët e këtij grupi qenë inxhinierë dhe teknikë, kuadro të aftë dhe të përgatitur në shkollën shqiptaro-amerikane “Harry Fultz”. Ata shiheshin me frikë patologjike si kundërshtarë të regjimit komunist. Ka qenë një gjyq me skenar të përgatitur kohë më parë. Gjyqi u hap në fillim të nëntorit 1946. Dështimi “gjoja” i tharjes së kënetës së Maliqit ishte veçse preteksti dhe sfondi tragjik ku u luajt akti i turpit dhe ndëshkimit të intelektualëve të radhës.

**Gjykata e Lartë Ushtarake e përbërë nga:** Nenkolonel Gaqo Floqi, Kryetar dhe kapitenët Veledin Zeneli e Neshat Hyseni, anëtarë dhe Prokuror Nevzat Haznedari dha vendimin:

**Dënohen varje në litar:** Abdyl Sharra inxhinier, Kujtim Beqiri inxhinier, i rivarur dy herë në litar, sepse herën e parë i shpëtoi varjes dhe sipas ligjeve të pashkruara hyjnore, personi konsiderohet i pafajshëm dhe i falet jeta. Por gjakatarët stalinistë nuk i njohin ligjet e Zotit.

**Dënohen me pushkatim:** Vasil Mano inxhinier, Zyraka Mano ekonomiste, bashkëshortja e tij, shtatzanë, që diktatura e pushkatoi me foshnjën në bark, Euxhenio Skaturo inxhinier Italian, Mirush

---

<sup>3</sup> Agron Tufa, *Fjalor Enciklopedik i viktimave të terrorit komunist*, Tiranë 2012, faqe 28-29.

Përmeti inxhinier. Me burgime të rënda u dënuan teknikët: Hans Vala, Mario Guarnjeri, Mihal Stratobërdha, Jani Vasili, Pandeli Zografi, mjeku italian Anastasio Riccio etj.

Disa ditë para largimit të Misionit Teknik Amerikan nga Shqipëria filluan arrestimet masive ndaj kuadrove të dalë nga shkolla shqiptaro-amerikane “Harry Fultz”. Me urdhër nga lart sigurimi i shtetit veproi egërsisht duke prangosur dhe torturuar rreth 80 intelektualë. Shkolla Teknike “Harry Fultz” ishte hapur në vitin 1921 në vijim të politikës dashamirëse ndaj kombit shqiptar të presidentit amerikan Uillson dhe drejtohej nga pedagogu i shquar Harry Fultz. Numri i kuadrove të larta nga kjo shkollë ishte 156 vetë. Në vend që të nderohej dhe të respektohej kontributi i këtyre kuadrove, pushtetarët e rinj vepruan pa mëshirë mbi ta duke i akuzuar si agjentë amerikanë. 22 vetë prej tyre u pushkatuan dhe të tjerët u dënuan me burgime të rënda.

**Të pushkatuarit dhe të vdekurit në hetuesi qenë:** Dino Shani, Jani Koljaka, Loni Adami, Mahmut Maci, Namik Haderi, Ndrek Kodheli, Abdyl dhe Xhelal Hamolli (binjakë), Anton Delhysa, Haki Pengili, Kamber Kazazi, Kostaq Stefa, Mehdi Kuqi, Namik Bardha, Neki Radovicka, Sami Sulstarova, Xheladin Kuqi, Hazbi Puto etj.

**U dënuan me burg:** Namik Xhelili, Beqir Haçi, Xhelal Ndreu, Halit Ndreu, Abdulla Karalliu, Xhemal Llalla etj. Zbatuesit e këtyre masakrave qenë prokurorët Aranit Çela, Nevzat Haznedari, Petrit Hakani, Subi Bakiri, Siri Çarçani etj. Ndërkohë që vendimet në emër të “popullit” jepeshin nga gjyqtarët Bexhet Mema, Myftar Grabocka, Njazi Meka, Abdyl Hakiu etj.

Në vitin 1947 qeveria komuniste shqiptare ndërromori një nga raprezaljet e saj më të mëdha, “sepse një pushtet i marrë me dhunë, nuk mund të mbahej ndryshe, veçse me akte dhune”. Kishin kaluar dy vjet nga zgjedhjet parlamentare të

vitit 1945. Për të mundësuar një “koperturë pluraliste” për opinionin në këto zgjedhje patën fituar edhe disa kandidatë nacionalistë si: Shefqet Beja, Kol Kuqali, Selaudin Toto, Sheh Ibrahim Karbunara, Kosta Boshnjaku, Riza Dani, Faik Shehu, Kol Rodhe etj, apo ndonjë kandidat i pavarur. Mirëpo demagogjisë për mendimin e lirë e të pavarur shpejt do ti dilte kallaji. Opozitarët kundërshtarë u arrestuan dhe u dënuan me akuza nga më të pabesueshmet.

**Trupi gjykues i përbërë nga kryetar:** Major Niko Ceta dhe anëtare kapiten Nexhat Hyseni, kapiten Mustafa Iljazi me prokuror Josif Pashkon japin dënimin:

**Me varje në litar:** Shefqet Beja, Riza Alizoti, Sulo Klosi.

**Me pushkatim:** Sheh Karbunara, Enver Zazani, Selaudin Toto, Salim Kokalari, Irfan Majuni, Tefik Deliallisi, Beqir Çela, Hysen Shehu, Pertef Karagjozi, Abdyl Kokoshi, Agathokli Xhitomi, Paolo Sagiotti. Kol Kuqali dhe Ferit Hysen Begasi kanë vdekur nga torturat në hetuesi.

**Dënohen me burgim të rëndë:** Foto Bala, Gjovalin Vlashi, Ramazan Tabaku, Ram Marku, Isuf Hysenbegasi, Irfan Pustina, Isuf Vrioni, Rustem Sharra, Sulo Konjari, Haki Karapici, Shefki Minarolli etj.<sup>4</sup>

Historia e diktaturave ka treguar se çdo regjim për të përligjur aparatit shtypës si forcë dhune ka nevojë të krijojë armiq. Nuk kishin kaluar as tre muaj nga i ashtuquajtimi “gjqyqi i deputetëve” dhe më 31 dhjetor të vitit 1947 në sallën e Garnizonit të Tiranës, në orët e vona të natës u zhvillua gjyqi i grupit të Riza Danit, pa dëshmitarë dhe pa mbrojtës, pa prova dhe fakte, por vetëm se u komunikojë vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake i firmosur nga Major Major Niko Çeta, Kryetar, Kapiteni i Parë Nexhat Hyseni dhe Kapiteni i Dytë Mustafa

---

<sup>4</sup> Melsi Labi, Dorian Koçi, *Udhërrëfyes i Muzeut Historik Kombëtar*, Tiranë 2014, faqe 75.

Iliazi, antarë dhe me prezencën e Prokurorit ushtarak Nevzat Haznedari, Kapiten i Parë u dha vendimi fatal për 19 të pandehur. E gjithë kjo bëhej mbi bazën e një promemoreje percjellëse që vinte nga hetuesia, krejtësisht me sajime dhe shpifje të turpshme.

**Dënohen me vdekje me pushkatim:** Riza Dani, Faik Shehu, Islam Radovicka, deputetë të legjislacionit të parë të Kuvendit Popullor. Uan Filipi, Hilmi Hysi, Hasan Reci. Ndërsa Syrja Selfo vdiq në qeli.

**Dënohen me burgim të përjetshëm:** Koço Boshnjaku, (deputet 1945), Mestan Ujaniku, Isuf Hysenbegasi, Hivzi Kokalari, Adem Beli, Demir Kallavati dhe me 20-25 vjet burg Bexhet Shehu, Ibrahim Hasnaj, Nexhmi Balla etj.

Shteti i diktaturës asnjëherë nuk do të ndalej së fabrikuari kurthe, për të eliminuar kundërshtarët politik. Kundër tyre do të përdorte të gjitha mjetet e dhunës. Kështu ndodhi më 19 shkurt 1951. Në oborrin e Ambasadës Sovjetike në Tiranë u hodh një bombë, e cila theu dy-tri xhama dhe ngriti një rë pluhuri si për të mbështjellë me mister ngjarjen që u fabrikua më pas nga diktatura. Ajo që ngjau vuri në lëvizje krejt makinerinë shtetërore e veçanërisht sigurimin e shtetit. U bënë arrestime masive, duke trumbetuar për armikun e klasës që kërkonte të prishte urat e miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Në Tiranë u arrestuan 22 vetë dhe u nxorrën në gjyq me dyer të mbyllura, si “armiqt të betuar të popullit” dhe të pushtetit popullor. Gjykata e Lartë Ushtarake me kryetar Shuaip Panaritin nënkolonel, Vangjel Kocani anëtar, kapiten, Nonda Papuli anëtar, kapiten, dhe Prokuror Siri Çarcani dhanë vendimin:

**Dënohen me vdekje me pushkatim:** Sabiha Kasimati, Pjerin Guruziu, Anton Delhysa, Zyhdi Herri, Gafur Jegeni, Jonuz Kaceli, Manush Peshkepia, Niko Lezo, Lluka Rrashkovic, Haki Kodra, Reis Selfo, Myftar Jegeni, Thoma

Katundi, Tefik Shehu, Gjon Temali, Fadil Dizdari, Ali Qoraliu, Qemal Kasaraho, Mehmet Shkupi, Hekuran Troka, Petro Konomi, Pandeli Nova.

Në mesnatën e 26 shkurtit të vitit 1951 viktimat e kësaj historie të dhimbshme, i nxorrën nga qelitë dhe i lidhen me tël hekuri njeri me tjetrin. Ata nuk e dinin se ku po i shpinin, nuk e dinin se do t'i vrisnin, sepse as i kishin gjykuar. Që nga ajo kohë kanë kaluar 56 vjet dhe mendimi i përgjithshëm është se bombën ne oborrin e Ambasadës Sovjetike e hodhi dora e zezë e sigurimit të shtetit. Skenari i kësaj ngjarjeje tragjike ishte projektuar në zyrat e Ministrisë së Brendshme. Kështu u shfaq haptazi fytyra e vërtetë e egërsisë komuniste që ushqej vetëm me viktimat të pafajshme për të ecur e sigurtë “nga fitorja në fitore”.

Një aspekt tjetër ka qenë goditja ndaj vlerave intelektuale të shoqërisë shqiptare pas marrjes së pushtetit nga klika komuniste. Gjyqet speciale dhe ato ushtarake, ekzekutimet, burgimet, internimet, përveçse eliminuan lirinë politike dhe njerëzore, kryen një masakër edhe ndaj grehinës intelektuale që kishte arritur të krijonte një shtrat të qëndrueshëm në trashëgimnë kulturore kombëtare. Njerëzit që u vunë nën shënjestër të regjimit dhe ranë pre e ndëshkimeve çnjerëzore si kundërshtarë politikë, qenë mendimtarë, shkencëtarë, studiues të fushave të ndryshme, shkrimtarë e artistë që me veprimtarinë e tyre kishin krijuar atë që mund të quhet “elita e kombit shqiptar”. Veprimet kriminale nuk u mjaftuan me ndëshkimit fizik, burgimin apo internimin, por atyre ju mohuan edhe veprat që kishin lënë ndër vite. Biblioteka të tera u rënuan apo u dogjën, mijëra dorëshkrime u zhdukën, shumë veprimtari shkencore u ndërpre në brutalisht dhe shoqëria shqiptare përjetoi me dhimbje plagën që i shkaktonte në trurin e saj. Ky ishte dhe dënimi i dytë më i rëndë se dënimi fizik.

Gjyqet e diktaturës nuk do të reshtnin së vepruari edhe pas vitit 1951. Diktatura e Proletariatit vazhdimisht do të prodhonte “armiç”. Për të zgjatur pushtetin ajo nuk do të ndalej përpara asnjë lloj krimi. Gjurmët i gjejmë nëpër burgjet dhe qelitë, në dëshmitë e atyre që i kanë mbijetuar ferrit komunist. Nëpër burgjet e diktaturës bluhej e mpihej mendimi intelektual. Në burgje kullonte gjak njeriu. Nëpër rrënojat e qelive të errëta të duket sikur dëgjon zhurmën e prangave dhe të goditjeve. Muret janë të heshtur, ajri i mykur, lagështira, por mbi to gjallon hija e kujtimit të atyre që mundën të mbijetojnë. Mjerë ata që hoqën e vuajtën në ferrin e gjatë komunist. Sa shumë është për t’u thënë e për t’u kujtuar. A do të na besojnë të tjerët? A do të na besojnë fëmijët tanë? Prandaj është domosdoshmëri dokumentimi i krimeve të diktaturës dhe totalitarizmit komunist shqiptar. Ajo që ndodhi në Shqipëri nuk ka ndodhur në asnjë vend të botës. Nuk e meritonte ky vend të ndëshkohej kaq rëndë. E drejta nis nga drejtësia, gabimi i gjatë bëhet faj dhe faji i ndërgegjegjshëm kthehet në krim. Dhe pas shkatërimit vjen lehtësimi. E pra, nuk duhet të harrojmë! Veçanërisht ne shqiptarët, kurrë nuk duhet të harrojmë atë diktaturë të egër ç’ njerëzore është thirrja që buçet nga kori i të pafajshmëve...

### **Strasburgu dënon krimet e diktaturës komuniste**

Më datën 25 janar 2006 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka miratuar një rezolutë, me anën e së cilës dënon krimet e komunizmit duke i cilësuar ato si ekuivalente me krimet e nazizmit. Shqipëria si vend anëtar i Këshillit të Evropës është e detyruar të përmbushë të gjitha rekomandimet e komunitetit ndërkombëtar. Shqipëria përfaqësohej prej Deputetit të Partisë Demokratike Bujar Nishanit, i cili votoi pro rezolutës. Fakti që Shqipëria votoi pro kësaj rezolute është për tu përshëndetur, sepse ajo ka vuajtur diktaturën më të egër nga të gjitha vendet

komuniste. Në Shqipëri në harkun kohor ndërmjet viteve 1945-1956 janë pushkatuar dhjetë mijë njerëz, 16 mijë të burgosur kanë vdekur nga torturat dhe uria, ndërsa 80 mijë njerëz të tjerë janë burgosur dhe internuar. Të habit fakti se gjithë këto krime çnjerëzore nuk janë dënuar nga komuniteti ndërkombëtar.<sup>5</sup>

Të 315 deputetët e Këshillit të Evropës votuan projekt-rezolutën për dënimin e genocidit komunist. Asambleja ju bën thirrje të gjitha vendeve, të cilat janë qeverisur nga regjime komuniste totalitare, që të përcaktojnë një ditë përkujtimore për viktimat e komunizmit dhe të hapin muze për krimet e komunizmit. Ja se çfarë thotë Projekt-rezoluta:

1-Asambleja i referohet edhe rezolutës së saj 1096 mbi masat për çmontimin e trashëgimisë së regjimeve ish-komuniste totalitare.

2-Regjimet komuniste totalitare që ishin në fuqi në Evropën qendrore e lindore në shekullin e kaluar dhe që ekzistojnë edhe sot në shumë vende të botës, janë shquar pa asnjë përjashtim për shkeljen masive të të drejtave të njeriut. Këto shkelje që dallojnë sipas kulturës, vendit dhe periudhës historike përfshinin vrasje dhe ekzekutime, individuale ose kolektive, vdekje në kampet e përqendrimit, vdekje nga uria, internime, tortura, punë të detyruar dhe forma të tjera të terrorit fizik kolektiv.

3-Këto krime janë përligjur në emër të teorisë së luftës së klasave dhe të parimit të diktaturës së proletariatit. Interpretimi i këtyre parimeve e bënte legjitim eliminimin e kategorive të personave të konsideruar si të dëmshëm për ndërtimin e shoqërisë së re dhe për pasojë, shiheshin si armiq të regjimeve komuniste

---

<sup>5</sup> Sejdi Peka, *Strasburgu dënoi krimet e diktaturës komuniste*, “RD”, 3 shkurt 2006, faqe 12.

totalitare. Në çdo vend shumica e viktimave ishin shtetas të tij. Kështu ka ndodhur edhe me viktimat e ish-Bashkimit Sovjetik, i cili ka patur më shumë viktime sesa të gjitha vendet e tjera.

4-Asambleja pranon se megjithë krimet e regjimeve komuniste totalitare, disa parti komuniste europiane kanë kontribuar për realizimin e demokracisë.

5-Rënia e regjimeve komuniste totalitare të Europës qendrore dhe lindore nuk u pasuan me një hetim ndërkombëtar shterues dhe të thelluar, as me një debat mbi krimet e kryera nga këto regjime. Përveç kësaj, këto krime nuk janë dënuar nga komuniteti ndërkombëtar, siç u bë me krimet e kryera në emër të nazizmit.

6-Për pasojë publiku i gjerë është pak i ndërgjegjshëm për krimet e kryera nga regjimet komuniste totalitare. Partitë komuniste janë legale dhe nganjëherë aktive në disa vende, edhe pse nuk janë distancuar nga krimet e kryera në të kaluarën nga regjimet komuniste totalitare.

7-Asambleja është e bindur se ndërgjegjësimi për historinë është një nga kushtet që duhet përmbushur që krime të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Më tej, gjykimi moral dhe dënimi i krimeve luajnë një rol të madh për edukimin e brezave të rinj. Një pozicion i qartë i komunitetit ndërkombëtar për këtë të kaluar do t'u shërbejë të rinjve si pikë referimi për veprimtarinë e tyre në të ardhmen.

8-Gjithashtu, Asambleja është e mendimit që viktimat e krimeve të komunizmit, ende gjallë apo të afërmit e tyre, apelojnë për solidaritet, mirëkuptim dhe njohje të vuajtjeve të tyre.

9-Ka ende regjime komuniste totalitare në disa vende të botës ku krime të përbindshme vijnë të kryhen. Të ashtuquajturat interesa të vendit nuk duhet të pengojnë asnjë vend tjetër të kritikojë regjimet komuniste aktuale kur ato e

meritojnë të kritikohen. Asambleja dënon me forcë të gjitha këto shkelje të të drejtave të njeriut.

10-Debatet dhe dënimet që janë kryer deri tani në rang kombëtar në disa vende anëtare të KE nuk mund ta pengojnë komunitetin ndërkombëtar të pozicionohet qartë për krimet e kryera nga regjimet komuniste. Kemi detyrimin moral ta bëjmë këtë pa humbur kohë.

11-KE është organizmi i duhur për të hapur një debat të tillë në nivel ndërkombëtar. Të gjitha ish-vendet komuniste të Evropës, përjashtuar Bjellorusinë, janë anëtarë të tij dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e shtetit të së drejtës janë vlerat themelore që ai mbron.

12-Për këtë arsye Asambleja dënon me forcë shkeljet masive të të drejtave të njeriut të kryera nga regjimet komuniste dhe përkulet para viktimave të këtyre krimeve.

13-Gjithashtu ajo fton të gjitha partitë komuniste ose post-komuniste të vendeve të saj anëtare që nuk kanë kryer ende këtë akt, të rishikojnë historinë e komunizmit dhe të kaluarën e tyre, të distancohen qartazi nga krimet e kryera në regjimin komunist dhe t'i dënojnë ato sinqerisht.

14-Asambleja vlerëson që qartësia e këtij pozicioni të votuar nga komuniteti ndërkombëtar do të favorizojnë vazhdimin e pajtimit. Ajo shpreson se ky akt do të inkurajojë historianët e të gjithë botës për të vazhduar kërkimet e tyre për të vendosur dhe për të verifikuar objektivisht historinë e regjimeve komuniste.<sup>6</sup>

Inspiruesi i kësaj rezolute është deputeti i djathtë i parlamentit suedez Goran Lindbland. Miratimi i kësaj rezolute do të sjelli detyrime morale edhe për vendin tonë në ndërmarrjen

---

<sup>6</sup> *Dokumenti i plotë i KE për dënimin e krimeve të komunizmit*, "Expres", 26 janar 2006, faqe 10.

e hapave të mëtejshëm për dënimin e krimeve të bëra nga sistemi totalitar monist. Shoqëria e përparuar shqiptare e ka dënuar sistemin monist dhe tashmë nuk mund të kthehemi prapa. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që me fitoren e demokracisë u morën masa për integrimin e të burgosurve politikë, të cilat nuk vazhduan me ato ritme që qenë parashikuar. Janë bërë hapa të rëndësishëm në rehabilitimin dhe kompesimin e viktimave të diktaturës, por këto nuk u vazhduan dhe kanë ngjallur pakënaqësi. Gjithashtu ligji për “Krime kundër njerëzimit” ishte një hap tjetër drejt reformave demokratike.<sup>7</sup>

Të gjitha regjimet e vendeve komuniste kanë dhunuar të drejtat e njeriut. Me anën e luftës së klasave, e cila ishte thelbi i diktaturës së proletariatit, këto regjime janë përfshirë në vrasje, ekzekutime dhe përndjekje nga më mizoret. Krimet e shkaktuara prej komunizmit janë të njënjta me ato të nazizmit, prandaj duhen dënuar. Projekt-rezoluta për dënimin e krimeve të kryera nga regjimet totalitare komuniste duhet të gjejë mirëkuptim të ndërsjellë dhe keqardhje për të gjitha viktimat.<sup>8</sup>

Shumë vende ish-komuniste me kohë kanë bërë ligje sipas procedurave përkatëse dhe e kanë dënuar genocidin komunist. Ndërsa në Shqipëri ende nuk po veprohet. Administrata shtetërore është mbushut plot me ish-sigurimsa, me ish-prokurorë etj, të cilët i kanë duart e lyera me gjak. Lind pyetja: -A mund të vazhdojë të kryejë detyrën e tij një prokuror, i cili ka dënuar njerëz të pafajshëm? Me qëllim që demokracia të ndërtohet me themele të sigurta duhet që ata njerëz që i kanë shërbyer diktaturës komuniste të kërkojnë falje publike.

---

<sup>7</sup> Skerdilajd Zaimi, *Shqipëria, a e ka dënuar epokën komuniste?*, “Expres”, 24 janar 2006, faqe 2.

<sup>8</sup> Rafaela Rive, *Drejt një Nurembergu kundër komunizmit*, “Le Monde”, 22 janar 2006.